



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr:97

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN ME NR. 10, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË  
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** Z. Agron Malaj  
Kryetar i Bashkisë Mat

Zj. Bora Muzhaqi  
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

**OBJEKT:** Promovim i veprimtarive publike me karakter social, promovim në rrjete sociale me profil zyrtar i investimeve të Bashkisë Mat dhe përdorimi i burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullaror

**K O N S T A T O J :**

Partia Demokratike, më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 10 ID.

Data: 14.02.2025

Nr: 97  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin me nr. 10, datë 10.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“1. Bashkia Mat ka shpërndarë ushqime dhe ndihma për familjet në nevojë në qytetin e Matit, duke nisur në këtë formë krimin zgjedhor.*

*2. Kryetari i Bashkisë Mat Agron Malaj në rrjetin e tij social Facebook ka shpërndarë dhe promovuar ngritjen e Qendrës Rinore Mat. Në rrjetin e tij social numërohen dhjetra postime me sfond propagandistik duke promovuar punën e Bashkisë Mat.*

*3. Në ditën e promovimit të ngritjes së Qendrës Rinore Mat Kryetari i Bashkisë ka qenë i shoqëruar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe fëmijët, zj. Bora Muzhaqi”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Z. Agron Malaj, Kryetar për Bashkinë Mat;
  - Zj. Bura Muzhaqi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**